

KUR POETI TË FRYMËZON TE BEHESH POET

Nga Gjekë Marinaj

Nganjëherë, kur ditës m'i humbet ndonjë minutë gjatë rrugës për te dita tjetër, marr guximim që ato fragmente të vogla kohore t'i kaloj vetëm me veten. Çaste të tilla i vlerësoj shumë, sepse ato i jetoj pa ndrojtjen se si të tjerët mund t'i gjykojnë veprimet apo mendimet e mia. Herë gëzohej edhe për gjëra të vogla, herë ankohej vetëm për natyrën e gjërave e nganjëherë, ashtu pa prituri, i bëj ndonjë pyetje retorike vetes.

Sot, kur po shkruaj keto rreshta, më ndodhi kjo e fundit; dhe pyeta veten disi çuditshëm: përse sot, në epokën e informacionit, nuk kemi një njësi të saktë matëse për të matur madhësitë e poetëve dhe të artit të tyre?

Si zakonisht, as këtë herë nuk gjeta përgjigje të saktë për pyetjen që i bëja vetes. Por u lehtësova disi kur mendova për burimin e pyetjes. Ajo më kish ardhur nga një ngacim i pazakontë shpirtëror. Më filloi që nga leximi i poezive të para të librit Loti Alpin, libri më i fundit i poetit tonë të madh Agim Shehu. Janë lirika intime Zvicre, e po ashtu meditime të thella të sotme Shqipërie, të para si të kristali i një loti Alpin. Thënë pa mëdyshje, universi poetik i autorit në këtë vëllim është i jashtëzakonshëm. "Dëborë e parë" është vetëm njëra prej poezive të këtij libri mrekullisht të bukur:

Po binte e hollë e hollë,
e hutuar.

Vellon e bardhë të dritarja ma shtriu.

Kërkonte nusen...

pa gruan time të thinjur
dhe shkriu (Shehu 73).

U përkula mbi motivet me ndjenjën e përfytyrimeve, në fillim të papërcaktuara, siç u ndodh poetëve perballë njeri tjetrit, pavarësisht nga emri i tyre. Loti Alpin, pa u kuptuar, ndjenjën time intime ma kaloi te një kujtim i largët, që menjëherë m'u ribë i afërt. Hyra te lidhjet që kam patur në rininë time me një vajzë, të cilën në atë kohë e doja më shumë se veten... Kur isha pranë

saj, të gjitha vajzat e tjera të botës bëheshin asnjëse, disi ireale!

Ngjashmërisht, edhe tek po lexoja librin Loti Alpin, të gjitha librat e tjerë që më mbushin bibliotekën nga gjithë bota, m'u bënë për një ças asnjans. Thua i futur brënda një "loti" befasues, një çast po u lutesha, -më leni pak vetëm!

Vajza që dikur e doja marrëzisht me dukej aq e tejdukëshme, sa më bëhej se dritëzohesha kur hyja e dilja te bukuria e saj.

Diçka të tillë po përjetoja dhe te magjia e lirikave të reja të Agim Shehut. Poezia e atyshme është aq brilante sa mendon se trupi i diellit, veçanërisht nëpër kristalin zvicran, është prej poezie dhe rezet e tij prej vargësh.

Vajza e dikurshme ka qënë aq njomake, sa kisha frikë të vija buzët në gushën e saj. Po kështu me Loti Alpin: bukuria e lirizmit është aq e freskët sa ke frikë ta lesh për më vonë leximin e poezisë të faqes tjetër.

E doja dikur atë vajzë se ish aq e virgjër, sa paprekshmëria e saj më dukej hyjnore, aq sa turpëroheshja për energjinë e ndjenjave të rinisë... Pavarësisht se në një formë tjetër, instiktivisht tregova kujdes edhe me Loti Alpin, se poezia e atyshme m'u shfaq si një det i virgjër me imazhe të holla Zvicre mbi dallgë dhimbjesh Shqipërie; të ndërrojë faqet pa kujdes, të bëhej se turbulloje diçka tejfundësisht të kthjellët brënda saj.

Por ngaqë çastet te vetja jetojnë më pak se koha që nevojitet për të shqiptuar fjalën "publik", tani që po përfundoj së shkruari këto dy fjalë për librin e poetit Agim Shehu, ndjem përse i pjestar i jetës publike. Ndaj krahasimim e librit të sapolexuar me vajzën që pata dashur dikur, nuk e pashë të arësyeshme ta mbaja "privat".

Kjo edhe për një arsye tjetër. Ndonëse tani jam i martuar dhe gruan time e dua shumë më tepër se çdo femër në botë, para martesës me Dusetën ka qënë një kohë që për vajzën për të cilën fola, kam ndërje një dashuri të madhe. Nga ana tjetër, kushdo që merr penën për të shkruar letërsi, të paktën për mua, ka diçka të shenjtë në vetvete. Dashuria e pastër që kam për letërsinë më ka bërë që të njihem nga afër

me disa nga majat më të larta të letërsisë botërore. Megjithatë duhet thënë se, aq sa dëshiroja të isha i dashuri i saj asajkohe, do dëshiroja të isha dhe autori i Lotit Alpin sot.

Për mua ka qënë e pamundur sa dhe e kotë që t'i kërkoja asokohe asaj vajze të bukur të ma falte dashurinë, sa ç'është sot e pamundur t'i them Agimit të më falë autorësinë e këtij libri të mrekullueshëm.

Herë herë nëpër faqet e librit i mbyll ato, si për të shijuar një lodhje të këndëshme poetike që të japin lirikate befasuese. Të vjen natyrshëm mendimi: Si është e mundur që poeti, në moshën e thyer, të shkruajë lirikate ndër më të bukurat e jetës së tij?! Rinia ka ardhur te poeti i moshuar, apo ai, i përmallshëm, ka vizituar rininë e tij?! I është përlur, dhe me falje, për motivet që në rini diktatura nuk mund t'ia linte të shpreheshin kështu lirisht, apo vetë autori i ri nuk i kishte vënë re ato! Sidoqoftë, të vjen në ndihmë gjykimi i Hegelit, se poeti dëshminë e plotë e jep pas moshës 50 vjeçare, ahëre kur është çliruar nga klishtë e retorikës së ftohtë. Ja sa ëmbëlsisht e percepton Shehu idenë e Hegelit:

Valluesit venë drejt një ngjyre
dalin prej një drite...

Globi pas tyre shpejton rrotullimin
në ndrimin e viteve (Shehu 44).

Lirikate e Lotit Alpin dëshmojnë magjinë e vërtetë që ato duhet të kenë, një harmoni të poezisë me filozofinë, ku ndjenja është vala dhe mendimi është anija sipër saj. Lexuesi lundron në një muzg të lodhur nga jeta dhe të bukur nga arti. Fjalë të vëna natyrshëm në poezi si gurët e ngjyrshëm në mozaikë! Përmbi to, marrim frymë si me frymëmarrjen e luleve spërkatur me një vesë stuhie. Dufe ndjenjash që rjedhin si ujvara, e rrotull tyre një blerim i virgjër në rrepara shkëmbejsh si të vëndlindjes së autorit, të cilat nuk i ndahen nga sytë. Mall për shokët nën fluturime zogjsh të Shqipërisë, shoqëruar nga plumbat... goditja e autorit nga bandat komuniste në fuqi, dhe pas-

taj, poema e mbylljes "Faleminerit, Zvicër!"

Mirupafshim Shqipëri!
Ika se të dua shumë;
se desha të jem gjallë
dhe ca kohë për ty (Shehu, 84)...

...Sot jam një meteor i djegur
Që këputet, e s' di ku bie (Shehu, 85)!

Lexoj këto lirika, e flas çiltër me gjuhë poeti ato mendime që nuk thuhet dot kurrë të plota, ashtu si asnjë dashuri e bukur nuk shprehet dot kurrë me fjalën e saktë që ajo meriton. Ndodhesh midis reales e ireales, në një lloj bote ënderash, nga e cila nuk ke dëshirë të zgjuhesh kurrë.

E ç'ëndësi ka që nuk arrita kurrë për të qënë i dashuri i vajzës nga Bajza, e se po ashtu, ndoshta nuk do arrij kurrë të jem autor i një libri me të njejtin nivel si Loti Alpin! Gjërë janë ashtu si janë dhe jeta është ashtu si është. Për mua është shumë e rëndësishme që ajo vajza më pat dhënë disa nga çastet më të bukura për dashurinë time të herëshme. Po kështu poeti Agim Shehu me Lotin Alpin më hapi një dritare të re nga një lëndinë e virgjër poezie, diku në shpatin e dashurisë sime për letërsinë e sotme.

Kënaqësia e përjetimit të lidhjeve të mia shpirtërore me këto dy bukur, disi të ndryshme në llojin e tyre, do më mbetet e pazëvendësueshme. Në poezi, si në dashuri, e rëndësishme është të mbetesh mirënjohës deri në fund para vlerave të mëdha shpirtërore, të cilat mund të mbijetojnë përjetësisht dhe brënda një "loti".

Poetit tonë të shquar në mërgim këtë "lot" lirizmi ia dha Zvicra, dhe pikërisht në moshën e thyer të tij. Se çfarë do të shkruajë ai më tej, këtë e di vetëm shpirti si laborator prej ylberi i poetit, aq më tepër në mërgim ku lirizmi qëndron lidhur te drama si blerimi te toka.

Citimet e punës:

Shehu Agim. Loti alpin. Tiranë: Albin, 2002.



Poezi nga Agim Shehu

KOSOVE PRANVERE 1998

-fragmente-

Para bustit të Selam Musait

Koha hedh paprerë
përmbi festën tënde
dimri- flokë bore
vera -dritë hëne
Dhe të vijnë të veshim
rreth duke t'u mbledhur
ndërsa ti në heshtje
ri në bronx i derdhur
Eh gjithë këtë bronx
vallë ku ta gjeje
vetë do ta shkrije
plumba do ta bëje.
Ri... po nuk të rihet
ndaj të vijnë mornica
...vrapi yt po endet
poshtë nga Babica
...Lugjesh në ato netë
zbritë si veri
projektorët ndiqnin
sharkun tënd të zi.
Flaka nëpër duar
me rëmbim të futej
gjalmi mbi dyfek
dridhej mos këputej.
Plumbat nëpër xhepe
(gjetur breg pas bregu)
me thërime misri
hynin tek dyfeku

Dhe kërcisnin egër
plumbat tanë të rallë
se kish shpirtu mosri
se desh gjak në ballë.
Malet nëpër mjegull
sa i zgjoi pushka
kafshatë e gojës
varen poshtë mbi mushka.
Bukë për lirinë
moj kasolle të erta
dhe dridhen kapisrat
nga mushkat e sarta
"Biruni o burrani
hop...ti zemë së gjalli
dhëmbët nga urrejtja
Krisnin posi atralli
Deti sa të pa
kur në qafë dole
të thiri si nëna
ti si djallë i fole.
Dhe vërtiti valet
sa të pa tek shtegu
të të mir tek gjiri
të të sill te bregu.
Vlora krahëlidhur
c'vull të dha te gjuri
Malua nga ballkoni
të tundte flamurin.
Ndaj ti si i dehur
rrugën poshtë e more
po c'kish aq shumë tela
c'kish aq shumë illogore.
Plagë më plagë si lule
sec të doli gjaku
me të kuq flamuri
t'u qëndis shajaku.
"Kështu rëncim,-fole
e c'vlen sa liria
lule Labi ynë
Selam Salaria.
Plumbat breshërimë
t'u përmlodhën brenda
Lebërit koke më kokë
u ulën te kënga.
Si prush kënga jote
u digjte në ballë
ndërsa ti mes këngës
erdhe prap i gjallë.

Prapë ti i pari
zgjuar nga liria
o ti lule stralli
Selam Salaria.
Zilet e këmborët
heshtën përmbi pllaja
lugjet prape gjëmimet
gatuanin në maja.
Dhe sot retë nga mali
që gjëmimet sjellin
posi iso labe
vijnë e të pëshjtjellin.
Ti ngul sytë mes tyre
si mes luftëtarësh
sikur ri mendohesh
c'këngë do tja marësh.
Buzët ti te kënga
ballin te liria
lule,Selam Labi
Selam Salaria.
Cdo tufan zberthyer
gjoksin ty ta gjeti
sharku si legjendë
telave të mbeti.
E të vijnë te busti
si në prag të derës
po ti as duhanin
s'ke kohë të na dredhësh.
Duart i ke zënë
-Cke ashtu në duar?
grykë e nxehtë e topit
ti ka përvëluar.
Krahët me shajak
dredhur nëpër tytë
ahen nëpër hekur
sa të shkrepin sytë.
...Ja kështu në bronx
ty të ka liria
lule Selam Labi
Selam Salaria.
Përmbi festën tënde
qëkur ti ke rënë
Mali po derdh bore
fusha po derdh hënë.
Dhe rri,gjoksin hapur
ballë c' do furtune
Sharku si legjendë
telave lëkundet.

PËRKUJTIM

NË NJËVJETORIN E VDEKJES SË NEXHMIJE ZHERKËS



NEXHMIJE ZHERKA

(1957 - 2002)

Nexhmije Zherka lindi 46 vjet më parë në fshatin piktoresk në Jasenicë të Plavës, rrëzë Alpeve të larta e të bukura shqiptare.

Ajo, ishte femija ynë i parë, prandaj edhe gëzimi familjar për të ishte i madh.

Po t'i referohem vlerësimit që i bënte në atë kohë nëna e saj Shpresa si dhe prindërit e mi, del se natyra e Alpeve tona Nexhmijes i kishte dhuruar një dinamikë e një bukuri të rrallë, aq që përngjante në një lule alpine.

Nexhmija u rrit në një familje e në një rreth shoqëror me tradita të bukura të shqiptarizms, të cilat i dhanë ndjenjat humane të altruizms e të satisfaksionit.

Në rini alternativa e saj, ashtu si e mbarë familjes, ishte arsimimi dhe rruga e sakrificës në luftë kundër okupatorit serbosllav, gjë që së bashku me diasporën shqiptare, sadopak, ajo, dha një kontribut modest në lirinë e Kosovës. Nexhmija ishte, gjithashtu, një qytetare e denjë dhe oficere shembullore e kombit amerikan. Pikërisht për këtë, presidenti George W. Bush e vlerësoi me mirënjohje, pas vdekjes.

Në vitet e arta, kur Nexhmija e kishte ndërtuar vetërespektin nëpërmes arritjeve të saj, e rrëmbeu mortja, pikërisht, me 28 gusht 2002.

Ishte dhe mbetet e madhe dhimbja e malli për të, aq sa edhe krenaria që e patëm. Të falemdërit..., moj bijë!

E përkujtojnë prindërit: Ahmeti e Shpresa, vëllezërit: Sefedini, Naimi, Mediu, Iliri, Kujtimi, Luani si dhe antarët e tjerë të familjes Zherka, nga New York-u dhe trojet shqiptare në Atdhe.

Ahmet Zherka